



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KRYEMINISTRI

URDHËR

Nr. 136, datë 13.09.2018

PËR

NGRITJEN E GRUPIT NDËRINSTITUCIONAL TË PUNËS PËR ZBATIMIN E MASËS 51 TË PLANIT TË VEPRIMIT TË STRATEGJISË KOMBËTARE PËR DIASPORËN

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 12, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", të vendimit nr.259, datë 9.5.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Diasporën 2018-2024 dhe të planit të veprimit".

URDHËROJ:

1. Ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për zbatimin e masës 51 të planit të veprimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën, miratuar me vendimin nr.259, datë 9.5.2018, të Këshillit të Ministrave.
2. Grupi ndërinstitucional i punës të përbëhet nga:
 - ministri përgjegjës për diasporën; kryetar;
 - ministri përgjegjës për punët e jashtme; anëtar;
 - ministri përgjegjës për financat; anëtar;
 - ministri përgjegjës për arsimin; anëtar;
 - ministri përgjegjës për kulturën; anëtar;
 - ministri përgjegjës për turizmin; anëtar;
 - ministri përgjegjës për punët e brendshme; anëtar;
 - ministri përgjegjës për drejtësinë; anëtar;
 - ministri përgjegjës për shëndetësinë dhe mbrojtjen sociale; anëtar;
 - ministri përgjegjës për bujqësinë dhe zhvillimin rural; anëtar;
 - ministri përgjegjës për mbrojtjen e sipërmarrjes; anëtar;
 - titullari i Akademisë së Shkencave; anëtar;
 - titullari i INSTAT-i; anëtar;
 - titullari i Agjencisë Kombëtare për Diasporën; anëtar;
 - titullari i AKSHI-t; anëtar.



3. Titullari i AKSH-it, titullari i Agjencisë Kombëtare për Diasporën, si edhe anëtarët e grupit ndërinstitucional të punës të realizojnë takime periodike (cdo 6 muaj) për vlerësimin dhe koordinimin e faqeve të informacionit të institucioneve.
4. Ngarkohet titullari i AKSH-it që, brenda 5 (pesë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri, të përcaktojë koordinatorët për cdo institucion përgjegjës.
5. Ngarkohen Ministri i Shtetit për Diasporën, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Kulturës, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Brendshme, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, Akademia e Shkencave, INSTAT-i, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), Agjencia Kombëtare për Diasporën për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E M I N I S T R I
E D I R A M A